



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës (KP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Pejës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Menaxhimi i kontratave nuk është mbajt dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi).
- A2 Janë krijuar shpenzime shtesë (interesi) si rezultat i vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 275,239€.
- A3 Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara.
- A4 Dobësi në menaxhimin e subvencioneve.
- B1 Vonesa në pagesën e faturave.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Pejës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Pejës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Pejës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Pejës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Pejës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keq klasifikimi i shpenzimeve, menaxhimi jo i mirë i pagesave, dhe dobësi në menaxhimin e pasurisë. Përveç këtyre kemi identifikuar çështje tjera në menaxhimin financiar dhe të pajtueshmërisë, përfshirë të hyrat, menaxhimin e pasurisë, subvencione, dhe llogaritë e arkëtueshme. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja dhe katë (4) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja Pika 61. Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës së kontraktuesve paragrafi 20.f. i Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh “Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Nga testimi jonë, ka rezultuar se në pesë (5) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi) si:

- Rikonstruimi i rrjetit në fshatrat e Rugovës vlerë 385,605€.
- Ndërtimi i palestrës së sporteve në SH.F.M.U “Pjeter Budi” fshati Poqestë në Komunën e Pejës në vlerë 139,847€.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Baran i epërm, Kryshec, Rashiq dhe Broliq, vlerë 377,027€.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Nabergjan, Jabllanic e Leshanit, Leshan, Ramun, Zahaq dhe Gllaviqice vlerë 277,955€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e anashkalimit të përdorimit të procedurës së kërkuar nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikojnë në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit të lejojnë të marrin informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit apo nevojave tjera, për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore

Gjetja Neni 39 i LMFPP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishte 1,133,493€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 858,254€, ndërsa 275,239€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit, këto janë shpenzuar nga:

- kategoria e pagave dhe mëditjeve borxhi kryesor ishte 602,867€ ndërsa shpenzimet shtesë ishin 225,083€;
- kategoria e mallra dhe shërbime borxhi kryesor ishte 168,316€, ndërsa shpenzimet shtesë ishin 22,570€; dhe
- kategoria e investimeve kapitale borxhi kryesor ishte 87,071€, ndërsa shpenzimet shtesë ishin 27,586€.

Kjo ka ndodh si rezultat i mos pagesës me kohë të obligimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë, ku pjesa më e madhe ishte për shujta dhe transport për implementimin e kontratës kolektive, si dhe pagesave ndaj furnitorëve.

Ndikimi Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuar me bazën ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara

Gjetja Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: "Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në tri (3) raste, kemi evidentuar vonesa deri në 175 ditë. Vonesat kanë të bëjnë me projektet si në vijim:

- Kontrata "Ndërtimi i Çerdhes për fëmijë në lagjen Karagaq" në vlerë 242,684€, e nënshkruar me datë 12.05.2021, vonesa deri 175 ditë;
- Kontrata "Ndërtimi i hapësirave publike për rreth QKMF-së" në vlerë 95,365€, e nënshkruar me datë 15.07.2021, vonesa deri 167 ditë; dhe
- Kontrata "Rregullimi i parkut Karagaq" në vlerë 33,434.€, e nënshkruar me datë 19.10.2021, vonesa deri 126 ditë

Në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave. Po ashtu nuk janë aplikuar masat e ndëshkimeve për vonesa në realizimin e punëve.

Sipas zyrtarëve komunal, shkaku i vonesave në punë ishte rritja e çmimeve të materialit ndërtimor në treg për shkak të inflacioni, megjithatë, vonesat janë reflektuar edhe nga mungesa e kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo, po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që, përmes menaxherit të prokurimit, si dhe

menaxherëve të kontratave, se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja Sipas nenit 23 të rregullorës MF-Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare (OJQ), përcaktohet Monitorimi dhe raportimi projekteve dhe programeve: 1. Për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin.

Nga mostrat e testuara, në tri (3) raste ofruesi i mbështetjes financiare nuk ka caktuar zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Po ashtu, në një (1) rast OJQ nuk ka dorëzuar raporte financiare dhe narrative për vitin 2022.

Shkaku ishte mungesa e kontrollove të brendshëm dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës për ti zbatuar rregullat e përcaktuara sipas rregullores.

Ndikimi Mos caktimi i zyrtarëve përgjegjës të cilët duhen të kujdesen për monitorimin e implementimit të projektit, si dhe mos dorëzimi i raporteve narrative dhe financiare për periudhat raportuese, ndikon negativisht dhe krijon vështirësi në menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se caktohen zyrtar përgjegjës të cilët duhet kujdesen për monitorimin e implementimit të projekteve. Po ashtu të siguroj se OJQ-të përfituese të subvencioneve dorëzojnë raporte financiare dhe narrative.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Si dhe Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimin të faturës të ekzekutohet pagesa.

Nga testimi i mostrave, kemi identifikuar vonesa në pagesën e faturave e tejkalojnë kohën e paraparë me ligjin aktual. Në pesë raste faturat në vlerë totale prej 61,377€, pagesat nuk ishin bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat janë nga 80 deri 240 ditë kalendarike.

Po ashtu në pesë (5) raste tjera, faturat në vlerë prej 97,200€ së bashku me dokumentacionin mbështetës, ishin pranuar nga komuna para datës së kërkesës për zotim të mjeteve.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve, ishte planifikim jo i mirë i buxhetit dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve pa mjete në dispozicion dhe mungesa e komunikimit në mes të zyrtarëve përgjegjës. Më tutje, për rastet e pranuar nga komuna para datës së kërkesës për zotim të mjeteve, kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrollit të brendshëm.

Ndikimi

Detyrimet e bartura rrisin rrezikun në mos realizimin e projekteve dhe në mos arritjen objektivave të komunës, si rezultat i nevojës për t'i paguar (obligimet) zotimet e viteve paraprake njëherit kjo ndikon edhe në kosto shtesë në rast të padive nga furnitorët. Ndërsa, hyrja në obligime pa zotimin e mjeteve paraprakisht, mund ndikoj në mos pagesën në kohë të obligimeve, të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi B1

Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhen vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 135,479€ në kategori jo adekuate të cilat kanë të bëjnë me organizimin e panairit dimëror, organizimin e panairit verorë dhe rikonstruimi i rrjetit në fshatrat e Rugovës, përkatësisht:

- Nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar për subvencione dhe transfere në vlerë 33,689€.
- Nga kategoria subvencione dhe transfere janë paguar për investime kapitale në vlerë 81,790€.
- Nga kategoria investime kapitale janë pagur për subvencione dhe transfere në vlerë 20,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyra Vjetore Financiare.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 348,863,841€, pasurive jokapitale është 517,334€, si dhe e stoqeve 379,047€.

Çështja B3 - Mos regjistrimi i pasurive dhe prezantimi jo i plotë i tyre në PFV

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Në tri (3) raste, pagesat e shpenzimeve kapitale në vlerë 99,480€, nuk ishin regjistruar në regjistrat kontabël në SIMFK. Ndërsa në 15 raste, pagesat në vlerë 157,101€, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Po ashtu vlera e prezantuar e pasurive nën 1000€ në Pasqyra Vjetore Financiare ishte 517,334, kurse vlera e pasurive në regjistrat e e-pasurisë ishte 215,158€, ku kemi një mbivlerësim prej 302,176.

Shkak i mos regjistrimit të pasurive ishte mungesa e kontrolleve të brendshme ndaj zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2022 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 21,633,930€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 14,990,712€, taksa në ushtrim të veprimtarisë biznesore 6,391,030€, si dhe të tjera 252,189€.

Çështja B4 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Bazuar në neni 27 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme: "Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori".

Llogaritë e arkëtueshme në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 kishin rritje për 2,478,658€, veçanërisht të ndërmarrjet shoqërore (tatimi në pronë), ku borxhi ka vlerën prej 1,681,237€. Gjatë testimit të 17 rasteve, kemi evidentuar se komuna nuk kishte bërë përpjekje të mjaftueshme për inkasimin e mjeteve të pa arkëtuara nga tatimi në pronë, qiratë nga toka, dyqanet, tregjet apo taksat në firmë, duke mos dërguar letërkujtesa dhe duke mos iniciuar rastet në procedura përmbare. Trendi i rritjes së llogarive të arkëtueshme nga viti i kaluar është edhe me i lartë, rrjedhimisht kjo situatë po përsëritet ndër vite.

Shkaqet e rritjes së të arkëtueshmeve janë veprimi i pamjaftueshëm i komunës, që përmes organeve të drejtësisë të zvogëlojë borxhin e pa mbledhur nga klientët.

Ndikimi

Mos angazhimi dhe mos ndërmarrja e veprimeve për arkëtimin e të hyrave, ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës. Ky mos veprimi ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të këtyre llogarive dhe nga ana tjetër ndikohet trendi negativ i rritjes vit pas viti duke rrezikuar vjetrimin e llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi B4

Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimin të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	29,296,054	32,121,898	28,763,576	28,071,128	29,725,920
Grante Qeveritare - Buxheti	24,438,900	24,459,704	23,455,986	23,398,357	24,642,123
Financimi përmes huamarrjes	0	251,913	251,913	68,088	186,282
Të bartura nga viti i kaluar	0	2,223,049	1,581,174	873,599	579,274
Të hyrat vetanake	4,857,154	4,857,154	3,194,746	3,586,402	3,320,700
Donacionet vendore	0	25,472	0	14,777	27,000
Donacionet e jashtme	0	304,606	279,758	129,905	970,541

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 2,825,844€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprak, huamarrja dhe rimëkëmbja. Në vitin 2022 komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 8% në krahasim me vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	29,296,054	32,121,898	28,763,576	28,071,128	29,725,920
Pagat dhe mëditjet	14,887,342	15,202,047	14,500,277	14,902,939	14,686,862
Mallrat dhe shërbimet	3,700,000	4,115,868	4,041,842	3,582,232	4,132,109
Komunalitë	748,455	753,201	752,993	764,949	726,471
Subvencionet dhe transferet	531,016	610,829	570,394	469,590	471,545
Investimet Kapitale	9,329,241	11,439,952	8,898,071	8,351,418	9,708,932
Rezervat	100,000	0	0	0	0

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar në total ishte rritur për 314,705€. Kjo rritje ishte sipas vendimit të qeverisë për shtesat në paga pakoja fiskale në shumë 20,730€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 23,800€, garantëve të përcaktuara të donatoreve 18,175€ dhe financimi nga huamarrja 252,000€.
 - Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 415,868€, kjo rritje ishte sipas të hyrave të bartura nga viti i kaluar 180,000€ dhe granateve të përcaktuara të donatoreve 235,868€.
 - Buxheti final për shërbimet komunale ishte rritur për 4,746€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar.
 - Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 79,813€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar..
 - Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,110,711€, kjo rritje ishte si rezultat i vendimit të Kuvendit komunal për bartjen e mjeteve nga rezerva në investime kapitale 96,550€, të hyrave të batuara nga viti i kaluar në shumë prej 1,938,131€ dhe garantëve të përcaktuara të donatorëve për 76,030€.
- Komuna ka realizuar buxheti për investime kapitale 78%. Komuna ka 37 projekte të bartura nga vitet paraprake. Përqindja e realizimit të ulët është në 35 projekte si shkak i vonësive në punë si rezultat i ngritjes së çmimeve të materialit ndërtimorë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Pejës në 2022 ishin në vlerë 4,753,464€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga licencat, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 1,033,736€ (gjjobat në trafik 966,138€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 67,598€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	4,857,154	4,857,154	4,753,464	4,907,146	3,470,296
Të hyrat tatimore	2,913,782	2,913,782	2,354,504	2,455,933	1,412,091
Të hyrat jo tatimore	1,943,372	1,943,372	2,398,960	2,451,213	2,048,205
Të hyrat tjera	0	0			10,000

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të vitit 2021 ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar dhe katër (4) rekomandime nuk janë adresuar ende dhe një (1) rekomandim është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe Zyratri Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë. Po ashtu, të komunikojë me Departamentin e Tatimit në Pronë, që obligimi i tatimit në pronë për pronat komunale dhe për ato që janë në përdorim nga Forcat shumëkombëshe paqeruajtëse të shlyhet.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet financiare prezantohen në Pasqyrat Financiare Vjetore sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar

3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestininim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhen vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta, duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta, të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve do të respektohen kërkesat e dala nga rregullorja, ashtu që mbështetja financiare për OJQ-të, të bëhet me thirrje publike sipas kriteret të përcaktuara me rregullore.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
8.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
9.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të vendosur kontrollet e brendshme në mënyrë që të gjitha të hyrat e mbledhura dhe shpenzimi i këtyre mjeteve duhet të bëhet në përputhje me rregullat dhe sipas kërkesave ligjore.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar

10.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të ndërmarr veprime të duhura që në përputhje me ligjet në fuqi dhe vendimet ekzekutive të KPMSHCK dhe gjykatave kompetente të sqaroj dhe të zgjidhë këtë çështje ashtu që NjAB të ketë të emëruar një Drejtor të NjAB-së të zgjedhur me konkurs dhe të revokohet vendimi për ushtrues detyre i Drejtorit të NJAB-së.	Meqenëse çështja është ende në proces Gjyqësor, kjo çështje nuk është e aplikueshme.	Nuk është i aplikueshëm më
11.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të sigurohet se në të gjitha rastet kur përfituesit e subvencioneve nuk janë duke i zbatuar marrëveshjet e pranimit të subvencioneve, të ndërmerren masa që të kthehen subvencionet duke e respektuar të gjitha pikat e marrëveshjes së nënshkruar mes palëve. Gjithashtu, të vendosen masa adekuate të kontrollit që anëtarët e komisioni të vlerësimit të aplikacioneve për subvencione mos të jenë në konflikt të interesit.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, në mënyrë që komisionet e vlerësimit të tenderëve bëjnë vlerësim dhe krahasim të drejt të ofertave, po ashtu, të rishikoj procesin dhe të siguroj se është përzgjedhur OE i përgjegjshëm.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë në mënyrë të drejtë dhe të saktë për qëllime të raportimit dhe që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj procedura të qarta për inkasimin e llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me Agjensin Kosovare të Privatizimit lidhur me obligimet për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë në menaxhimin e tyre dhe që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre. Po ashtu, Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve, duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj borxhinjëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit




Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Pejës

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Pejës, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- Prej gjithsej 8 rekomandimeve të gjetura nga ZKA pajtohem me të gjitha.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Gazmend Muhajteri, Kryetar i Komunës së Pejës

Data: 15.06.2023



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.